



## TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.71

Njësia e Vendosur në Tender Nr.12

NSH Ereniku Prodhimtaria Primare-Parcelat 914-0 dhe 915-0 ZK Rastavicë

Emri i NSh.-së	Ereniku- Prodhimtaria Primare, Gjakovë ("Ndërmarrja")
Lloji i shitjes	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur
Dita e Ofertimit	Më 16.04.2025 nga ora 10:00h deri 12:00h në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë
Çmimi minimal	2,000 €/ari
Depozita e Ofertës	€ 10,000
Kategoria potenciale për shfrytëzim	Komerciale
<b><u>Përshkrimi i Aseteve</u></b>	
Vendndodhja e Aseteve	Zona Kadastrale Rastavicë, Komuna Deçan Të dhënat e hartës ©2024 Google <a href="#">Shikoni këtë pronë në Google Maps</a> Aktmohim: Vendndodhjet e treguara nga PIN-at në Google Maps ofrohen vetëm për qëllime të orientimit dhe referencës së përgjithshme. Këto mund të mos pasqyrojnë saktësisht vendndodhjen, kufijtë ose veçori të tjera të asetëve të përshkruara. Përdoruesit këshillohen të verifikojnë në mënyrë të pavarur të gjitha vendndodhjet për çdo çështje që kërkon saktësi ose informacion me rëndësi ligjore.
Ndërtesat dhe tokat	Kjo shitje ofron tokën që shtrihet në parcelat kadastrale me nr.914-0 dhe 915-0, ZK Rastavicë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 9374 m <sup>2</sup> (93 ari dhe 74 m <sup>2</sup> ) prej të cilave: -Parcela nr.914-0 ka sipërfaqe prej 4807m <sup>2</sup> , me kulturë: bujqësore- arë e klasës 4; -Parcela nr.915-0 ka sipërfaqe prej 4567m <sup>2</sup> , me kulturë: pyjor- mal i klasës 1, sipas gjendjes faktike parcela me nr.915-0 nuk është mal (mali ishte prerë).  Parcelat kanë qasje në rrugë publike ( parcelat nr.960 dhe 925); Parcelat janë të rrethuara. Parcelat ndodhen afër magjistrales Pejë- Gjakovë. Nuk ka ndërtesë në këtë shitje.
Shfrytëzuesit	Nuk ka ndonjë marrëveshje për shfrytëzimin e asetit në shitje.
Asetet tjera	Nuk ka.
Detyrimet që do të barten	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.



**Foto/fotot  
ose informata të tjera  
për asetet në shitje**





## RAPORT I VIZITËS NË TERREN

### KBI ERENIKU- PARCELAT NR.914-0 DHE 915-0 Z.K RASTAVICË

Me datë 09/12/2024 zyrtarët e AKP-së vizituan pronën e KBI Ereniku, konkretisht parcelat me nr.914-0 dhe 915-0 z.k Rastavicë, Komuna e Deçanit.

Parcelat sipas certifikatës së pronësisë evidentohen në emër të KBI Ereniku, me sipërfaqe të përgjithshme prej 9374 m<sup>2</sup> (93 ari dhe 74 m<sup>2</sup>) prej të cilave:

Parcela nr.914-0 ka sipërfaqe prej 4807m<sup>2</sup>, me kulturë: bujqësore- arë e klasës 4;

Parcela nr.915-0 ka sipërfaqe prej 4567m<sup>2</sup>, me kulturë: pyjor- mal i klasës 1.



Ortofoto dhe kopjet e planit për parcelat nr.914-0 dhe 915-0 z.k Rastavicë, Deçan

## Raporti i vizitës në teren



Nga vizita jonë në terren konstatuam se :

1. Siç shihet edhe në ortofoto dhe kopje të planit, parcelat kanë qasje në rrugë publike ( parcelat nr.960 dhe 925);
2. Nuk evidentohen objekte brenda parcelave të lartçekura ;
3. Parcelat janë të rrethuara;
4. Toka nuk ishte e punuar;
5. Sipas gjendes faktike parcela me nr.915-0 nuk është mal (mali ishte prerë).

Fotografitë e mëposhtme prezantojnë gjendjen faktike të parcelave :



D.G-Zyrtar Kadastral Rajonal   
M.D- Zyrtar i Operacioneve për Administrim të Aseteve   
AKP- ZR PEË/Dhjetor 2024

**Informatat dhe  
Dokumentet e Ofertimit**

Divizioni i Marketingut dhe Tenderit Publik  
Tel: +383 (0) 38 500 400 lok.1090,2059  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)  
Agjencia Kosovare e Privatizimit  
Rr. Dritan Hoxha, nr.55  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës